



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 6573/11 Prot.

Tirane, me 07.09 2017

**DEKLARATE MJEDISORE**

*per Vleresimin Strategjik Mjedisor*

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 91, date 28.02.2013 "Per vleresimin strategjik mjedisor" dhe akteve nenligjore qe rrjedhin prej tij, Ministri i Mjedisit, leshon kete Deklarate Mjedisore per:

Projekti: Plani Kombetar Sektorial te Turizmit per Alpet e Shqiperise

Kerkuesi: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes

Kufijte e zones qe mbulon plani: Rajoni i Alpeve te Republikes se Shqiperise

Perdorimi i deklarates mjedisore

Deklerata Mjedisore nuk perjashton detyrimin qe per projekte te vecanta te parashikuara ne kete Plan t'i nenshtrohen kerkesave te legjislacionit ne fuqi per vleresimin e ndikimit ne mjedis, per lejet e mjedisit dhe akteve te tjera normative ne fuqi.

Qendrimi i Ministrise:

Plani i propozuar ne parim perputhet me objektivat e mbrojtjes se mjedisit dhe zhvillimit te qendrueshem.

Duke realizuar nderhyrjet e duhura hapesine dhe duke zbatuar te gjitha masat e nevojshme zbutese, te gjitha grup-projektet jane te pranueshme nga kendveshtrimi mjedisor.

Perfshirja efektive e grupeve perkatese te interesit ka kontribuar ne cilesine e vleresimit, ka sjelle te dhena per analizen dhe raportin e VSM-se dhe do te mbeshtese zbatimin e planit pas miratimit te tij, si dhe do te kontribuojne ne nje pranim me te lehte dhe me te zbutur te projekteve perkates.

Ndikimet e mundshme ne mjedis te planit

Gjate zbatimit te projekteve/veprimeve, priten te ndohin impakte pozitive dhe negative. Impaktet positive priten per ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe per popullatat dhe asetet materiale. Vleresimi i rezultateve tregon se nuk do te kete impakte mbi faktoret klimatike duke konsideruar qe mjetet e transportit do te vijojne te rinovohen ne te ardhmen edhe me tej, gje qe do te sjelle si pasoje permiresim te cilesise se ajrit dhe cilesise se shendetit human,



midis te tjerave. Per me tej ne pjesen positive te impakteve mbi popullaten dhe asetet materiale do te vije si rezultat i zbatimit te infrastruktures ne pergjithesi qe do te beje te mundur pakesimin e kohes se udhetimit, sigurine ne levizje, perafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe sherbimet publike ne pergjithesi.

Pergjithesisht, shumica e impakteve negative jane te lidhura me fazen e planifikimit (pozicionimi i infrastruktures ne hapësire dhe pergatitja e kushteve teknike te pershtatshme), pasi Shqiperia ka vecori te theksuara diverse dhe te shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi qe mund te ndikohen konsiderueshem prej zhvillimeve te infrastruktures, sidomos atyre me shtrirje te gjere dhe korridoreve sipas sektoreve (transport, energji, uje, etj.). Impaktet negative shfaqen ne fazen e planifikimit prej aspekteve te perdorimit te tokes, efekteve ne uje, natyre (si biodiversiteti edhe zonat me status te mbrojtur), trashegimine kulturore dhe peisazhin. Keto impakte do te kerkojne krijimin e nje programi bashkekohor mbi masat zbutese dhe nje zbatim te pershtatshem te ketyre masave. Impakte negative mbi shendetin human mund te ndodhin per shkak te rritjes se ndotjes nga zhurmat dhe impaktet ne cilesine e ajrit, vecanerisht ne zonat me densitet te larte banimi ku do te perqendrohen edhe nje seri veprimesh ne territor te ngushte dhe kjo do te ndikojte kryesisht ne fazen e zbatimit te projekteve specifike.

#### Vleresimi i perputhshmerise se objektivave:

Objektivat strategjik per mbrojtjen e mjedisit nga zbatimi i ketij plani u vendosen mbi bazen e nje analize te plote qe prek:

- Analizën e elementëve mjedisorë të zonës;
- Karakteristikat mjedisore më të forta;
- Detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor vendas për ruajtjen e cilësisë së elementëve të ndryshëm mjedisorë;
- Detyrimeve nga kuadri ligjor ndërkombëtar për çështje të caktuara mjedisore;
- Detyrimeve të vendosura në dokumenta të ndryshëm strategjikë;
- Ndikimeve mjedisore potenciale që mund të shkaktohen nga aktivitetet e parashikuara në Plan.

Përputhshmëria e politikave të Planit është vlerësuar duke i kombinuar këto politika me objektivat mjedisore të kësaj VSM-je.

Ne baze te kombinimit te politikave te planit me te 12 objektivat mjedisore te VSM-se vleresohet se perputhshmeria e tyre eshte ne nivele te kenaqshme. Shperndarja e perputhshmerise eshte e ndryshme per fusha te ndryshme te planifikimit.

Per nje interpretim me ne detaje po analizojmë fushat kryesore te Planit Strategjik te Alpeve.

- Secila prej objektivave te Planit (pervec 2 objektivave qe lidhen me transportin dhe infrastrukturen) eshte ne perputhshmeri me te pakten 3 objektiva mjedisore;
- Secila objektive e planit eshte ne perputhje te pjesshme me te pakten 1 objektiv mjedisor;
- Nente objektiva te planit kane perputhje te plotë me me shumë se 3 objektiva mjedisore, dominojne ketu objektivat ne fushen e bujqesise dhe te mjedisit;



- Secila nga objektivat ka perputhshmeri te ulet me te pakten nje objektive te planit ku numrin me te larte e zene objektivat qe i perkasin fushes se ndëertimeve infrastrukture;
- E rendesishme eshte te theksojme se mungon vlere (-1) pra asnje nga objektivat e planit nuk paraqet mosperputhshmeri me objektivat mjedisore;

Ne analizen e vete objektivate mjedisore veme re se objektivi me i realizuar ne perputhshmeri eshte objektivi i pare; Toka – Perdorimi i qendrueshem i saj, si dhe Mjedisi natyror dhe Zonat e Mbrojtura.

Edhe ne kendveshtrimin e lidhjes mes objektivate te Planit dhe objektivate mjedisore diversifikimi i perputhshmerise eshte i larte. Sidoqofte dy objektivat mjedisore (i) Perdorimi i qendrueshem i tokes, dhe (ii) mjedisi natyror, kohezioni social, jane objektivat me nivelin me te larte te perputhshmerise me objektivat mjedisore. Persa i perket nivelit te larte te perputhshmerise se ulet qe verehet tek sektori i bujqesise konkretisht tek perpunimi i produkteve bujqesore mund te ndermeren masa parandaluese ne perdorimin e teknikave me miqesore me mjedisin.

Si konkluzion i pergjithshem mund te thuhet se objektivat dhe politikat e Planit Strategjik te Alpeve jane ne perputhshmeri me objektivat mjedisore.

#### **Detajimi i masave per mbrojtjen e mjedisit:**

Me qellimin per te shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative ne mjedis te planit ne te gjithe fazat e tij duhet te zbatohen me perpikmeri te gjitha masat e meposhtme.

- Te hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjate zbatimit te planit, me synim mbledhjen e te dhenave per ndikimet konkrete dhe pasojat ne mjedis gjate zbatimit te tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutese shtese, qe duhet te zbatohen per te garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan te hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklarates Mjedisore dhe te merret miratimi i autoriteve pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit.
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrrjes, nen mbikqyrjen e Agjencise Kombetare te Planifikimit te Territorit, qe zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit te hartoje nje raport vjetor per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit gjate zbatimit, te cilin duhet ta dergoje prane Ministrise se Mjedisit jo me vone se java e fundit e muajit nentor.
- Me qellim lehtesimin e realizimit te programit te monitorimit mjedisor te planit mund te perdoren programe ekzistuese monitorimi, qe perputhen me qellimin e programit te monitorimit mjedisor te planit.
- Projektimi i objekteve te bazohet ne parimin e teknologjise me te mire te disponueshme, e cila eshte efciente ne perdorimin e energjise, si perdorimi i teknologjiye izotermike te ndertimit per cdo objekt te ri po keshtu edhe ato te minimizimit te perdorimit te ujit.



- Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore te parashikuara ne Plan te sigurojne kohezion, efikasitet dhe qendrueshmeri dhe rritjen e perfitimeve per perdoruesit e kesaj infrastrukture.
- Plani duhet te nxite realizimin e projekteve te impianteve te trajtimit te ujrave te perdorur urbane dhe ne nje shkalle me te gjere duke e shtrire kete mase edhe ne aktivite e tjera industriale qe krijojne shkarkime ujrash industriale te ndotura dhe qe ndikojne sidomos ne cilesine e ujrave siperfaqesore dhe nentokesore. Te projektohet infrastrukture bashkekohore dhe afatgjate te kanalizimeve te ujerave te ndotura urbane.
- Te mbrohen vlerat natyrore te zonave ne te cilat shtrihet studimi dhe te shmangen ne maksimum demtimi i siperfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet te projektohen ne harmoni me kuadrin ligjor per mbrojtjen e natyres, duke respektuar shkallen e mbrojtjes se zones apo nenzones se mbrojtur ku do te nderhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve qe gjenden ne zone, si dhe te komunikohet/bashkepunohet me AKZM per te marre masat e domosdoshme per mos cenimin e statusit te ketyre zonave.
- Gjate fazes se projektimit dhe sidomos perpara nisjes se fazes se zbatimit te projekteve/aktiviteve specifike individuale te Planit duhet te perfshihen masa qe do te lehtesojne ruajtjen e korridoreve te kafsheve migratore. Ne rastin kur projektet qe do zbatohen mund te prekin zona te Mbrojtura apo mund te ndodhen ne afersi te tyre.
- Plani te marre masa per promovimin e transportit publik te pasagjereve qe te kontribuojne ne pakesimin e shkarkimeve ne ajer.
- Te zbatohen masa zbutese per zhvillimin e infrastruktures, gjate rehabilitimit/ndertimit duhet te parashikojne edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar “best practices“. Ne asnje rast nuk duhet te projektohet brenda, por as ne afersi te territorit te zonave te mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet ne ajer dhe zhurmat ndikojne ekosistemet dhe habitatet e llojeve nen mbrojtje. Promovimi brenda dhe ne periferite e zonave te mbrojtura duhet te jete ngritja e infrastrukturave te lehta qe mbeshtesin aktivitetet pa makina, ne drejtim te sporteve dhe aktiviteve ne natyre.
- Hartimi i planeve te menaxhimit te trafikut krahas prioritizimit te zonave te gjelberta publike, duhet te paraprijne planet urbane te zhvillimit dhe te kene objektiva te matshme per cilesine e ajrit.
- Te merren masa per mbrojtjen dhe mos demtimin e burimeve ujore qe gjenden ne zonen ne studim.
- Plani duhet te jete me konservator ne raport me ceshtjet e menaxhimit dhe cilesise se ujrave si sasi dhe cilesi, perfshire dhe akiferet. Projektet qe kane te bejne me perdorimin e ujit te konsiderohen me kondicione kufizuese mjedisore per aq kohe sa pasigurite dhe ireversibiliteti eshte i larte.
- Elementi i impaktit te mbetjeve te parashikuar kerkon te trajtohet qysh heret ne zhvillimin e masave, ne menyre integrale, ndersektoriale dhe ne lidhje me menaxhimin e tokes. Keto sisteme duhet te perfshijne 3R-te (Riciklimi, Riperdorimi, Reduktimi) si pjese e suksesshme e zbatimit ne praktike.
- Ne kuader te planifikimit te menaxhimit, vemendje e vecante te kushtohet per integrimin e zonave te sigurise nga permbytjet dhe atyre ligatinore, nderkohe qe masat e pyllezimit te synojne stabilizimin e humbjeve e tokes nga permbytjet (te zbatohet duke perdorur lloje te bimesise autoktone qe i rezistojne edhe permbytjeve).



- Para fillimit te zbatimit te projekteve te zgjidhet ceshtja e administrimit te volumit inert qe do te gjenerohet nga operacionet ndertimore.
- Te planifikohen dhe projektohen ne menyre strategjike elementet e administrimit te mbetjeve.
- Te projektohen elementet urbane te administrimit te mbetjeve (si vendi ku do te vendosen koshat e mbetjeve, koshat e vegjel te rrugeve etj.)
- Para fillimit te zbatimit te projekteve te zgjidhet ceshtja e administrimit te volumit inert qe do te gjenerohet nga operacionet ndertimore.
- Ne teresi, projektet specifike duhet te projektohen ne harmoni me standartet e ruajtjes se peisazhit dhe mbrojtjen e trashegimise kulturore, ku se bashku me elementet e cilesise se mjedisit te jene paresore duke aplikuar „best practices“.
- Gjate implementimit te planit te vihen ne zbatim masat zbutese e propozuara ne raportin e VSM-se per minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative ne mjedis.

#### **Detyrime dhe sanksione:**

- › Pavarsisht masave dhe rekomandimeve te kesaj Deklarate Mjedisore, gjate zbatimit te planit eshte e detyrueshme te zbatohen kerkesat e legjislacionit mjedisor ne fuqi;
- › Shfaqja e elementeve te rinj ekologjike te panjohur, ne kohen qe kjo Deklarate Mjedisore eshte dhene, sjell si detyrim rivleresimin e saj.
- › Nese plani nuk eshte miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit te deklarates, atehere deklarata behet e pavlefshme dhe procedura e VSM-se fillon nga e para.
- › Ne rast se ministria, strukturat e saj te varesise, njesite e qeverisjes vendore apo edhe grupet e interesuara, perfshi edhe publikun, konstatojne se plani nuk zbatohet ne perputhje me vendimin per miratimin e tyre dhe nuk respektojne kushtet e kerkesat e percaktuara per mbrojtjen e mjedisit, atehere ministria njofton menjehere autoritetin pergjegjes per zbatimin e miratimin e planit dhe, sipas rrethanave, i kerkon sqarimet perkatese apo ndalimin e menjehershem te zbatimit deri ne sqarimin e situates.
- › Nese pasojat ne mjedis e shendet, tejkalojne standardet mjedisore ne fuqi, atehere ministria i kerkon autoritetit miratues e propozues te merren masat e duhura apo te konsiderohet edhe ndryshimi i planit, me qellim qe te permbushen standardet mjedisore.
- › Per mos respektimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kjo Deklarate Mjedisore dhe te legjislacionit mjedisor ne fuqi ka sanksione ligjore.



**Lefter KOKA**  
**MINISTRI**